



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KOMUNA KUSHOVE  
GRAMSH

**K O N T R A T E**  
**PER KOLAUDIM PUNIMESH**  
Nr: \_\_\_\_\_ Prot.      Date 20/10/2014

**OBJEKTI: KOLAUDIMI I PUNIMEVE NE OBJEKTIN**  
**“RIKONSTRUKSION SHKOLLA SOTIRE”**

Nenshkruar ne Kushove midis Komunes Kushove perfaqesuar nga kryetari **Z. Xhevair BORA** i quajtur “INVESTITORI” dhe **Ing. Liliana VLLAMASI Person Fizik me nr NIPT K61905007L dhe me Licence MK. 0431/6 “Per Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi” date 04.02.2013** i quajtur tani e tutje “Kolaudator i Punimeve”

**OBJEKTI**

Objekti i kesaj kontrate eshte kolaudimi i punimeve per zbatimin e vepres:

**"Rikonstrukcion Shkolla Sotire"**

Vlera e Kontrates per kolaudimin e punimeve ne kete objekt eshte **12 000 (dymbedhjetemije) leke pa TVSH dhe 14 400 (katermbedhjetemije e katerqind) leke me TVSH** sipas njoftimit te fituesit ne tenderin per blerje me vlere te vogel me objekti prokurimi Kolaudim punimesh ne objektin: **" Rikonstrukcion Shkolla Sotire"**.

**II. VENDI I NDERTIMIT**

Vendi i kryerjes se punimeve eshte Komuna Kushove, Gramsh.

**III. GJUHA DHE LEGJISLACIONI**

Gjuha e perdorur ne formulimin e kontrates dhe çdo dokumenti tjetër lidhur me te eshte gjuha shqipe, ndersa ligji dhe aktet qe aplikohen per çdo gje lidhur me kete kontrate eshte legjislacioni Shqiptar

**IV. KOMUNIKIMI**

Komunikimi misdis paleve nenshkruese te kesaj kontrate do te behet me shkrim. Njoftimi behet efektiv vetem pasi dorezohet



## V. PERGJEGJESITE E KOLAUDATORIT

1. Kolaudatori i punimeve duhet te verifikojë me pergjegjesi:

- a. Realizimin e objektit ne perputhje me projektin, lejen e ndertimit, standartet dhe rregullat teknike.
- b. Realizimin e objektit ne perputhje me kontraten e nenshkruar.
- c. Perputhjen e dokumentave me te dhenat nga matjet ne dimension, forme, sasi dhe cilesi.
- d. Perputhjen e vleres se preventivuar dhe te kontraktuar me ate te paraqitur ne situacionin perfundimtar, si dhe sqarimet perkatese, ne rastet e mosperputhjes.

2.- Kolaudatori i punimeve kur veron defekte ne verifikimet qe percaktohen ne piken 1, le detyra me shkrim per punimet qe duhet te kryhen, duke percaktuar afatet e perfundimit te tyre ne menyre qe te plotesohen kushtet e pikes (1). Ne varesi te natyres se defekteve, percaktohen detyrimet e seciles pale:

3.- Pervec Kolaudimit ne fund te punimeve, eshte i detyrueshem kolaudimi edhe gjate procesit te punimeve ne rastet kur:

- a) Kur punimet jane komplekse dhe me veshtiresi te vecanta.
- b) Ne rastin e besimit te punimeve me koncension.

4.- Kolaudatori mer nje kopje te gjithe dokumentacionit te objektit i cili duhet te jete miratuar nga Mbikqyresi i Punimeve.

5.- Gjate procesit te Kolaudimit, Mbikqyresi Punimeve i pergjigjet Kolaudatorit me gjithe dokumentacionin e nevojshem per kolaudimin e vepres, si dhe firmos Aktin e ketij Kolaudimi.

6.- Ne perfundim te kolaudimit te vepres, hartohet proces verbali i kolaudimit i cili firmoset nga Kolaudatori, Sipermarresi dhe Mbikqyresi i Punimeve. Akti Kolaudimit **duhet te permbaje keto te dhena:**

- a) Vendimin e Ndertimit
- b) Emertimin e objektit dhe funksionin e tij
- c) Daten dhe prejardhjen e projekteve, si dhe ndryshimet e bera ne to
- d) Vleren e objektit
- e) Gjeneralitetet e sipermarresit
- f) Afatin e ndertimit
- g) Vleren e shpenzimeve (sipas rregjistrave te kontabilitetit)
- h) Gjeneralitetet e Kolaudatorit dhe specialitetet perkatese
- i) Kohen e zgjatjes se kolaudimit
- j) Pershkrimin e verifikimeve te bera mbi dokumentet dhe faktin, si dhe rezultatet e arritura

Akti Kolaudimit hartohet ne 4(kater) kopje origjinale, nga te cilat 1(nje) kopje e mer Invstitori, nje kopje Kolaudatori, nje kopje Sipermarresi dhe 1(nje) kopje Mbikqyresi i Punimeve. Ky Akti Kolaudimi i bashkelidhet dosjes te objektit.

7.- Kolaudatori nuk duhet te kete lidhje pune, gjaku apo interesi as me Mbikqyresin e Punimeve dhe as me Sipermaresin. Kjo behet me ane te nje deklarate me shkrim qe Kolaudatori i ben Investitorit.



*M. Vllamasi*

8.- Kolaudatori per kohen e punës që vihet në dispozicion të Investitorit paguhet prej tij në vlerën **14 400 (katërmbëdhjetemijë e katërqind) leke me TVSH.**

9.- Kolaudatori i Punimeve gjatë gjithë veprimtarisë së tij duhet të zbatojë të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe të Udhëzimit të KM Nr.4, datë 17.05.2001 “Për Drejtimin dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” ndryshuar me Udhëzimin e KM nr.1, datë 16.6.2011 Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar dhe mban përgjegjësi sipas dispozitave në fuqi për mos zbatimin e tyre

10.-Për çdo mosmarreveshje, palet e zgjidhin me mirekuptim, në të kundërt ato i drejtohen Gjykatës së Rrethit Elbasan.

11.Kjo kontratë përpilohet në 5(pesë) kopje.

**INVESTITORI  
KOMUNA KUSHOVË**

**Kryetari Komunes**

**Xhevair BORA**



**KOLAUDATORI  
Ing. Liliana VLLAMASI**

**Person Fizik**

